



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KONSULTATIV I BIZNESIT

**Mbledhja e Keshillit Konsultativ te Biznesit,
E Shtune, 02/06/2007, ora 11.00**

Minutat e takimit

Sot me date 02.06.2007 ora 11.00 prane ambjenteve te Ministrise se Ekonomise Tregtise dhe Energjetikes (METE) u zhvillua mbledhja e rradhes se Keshillit Konsultativ te Biznesit (KKB) duke ndjekur kete rend dite:

Rendi i Dites:

Diskutim lidhur me ndryshimet e Paketes Fiskale si me poshte:

- Per ndryshim ne Ligjin NR 9632 date 30.10.2006 “Per sistemin e Taksave Vendore”
- Per ndryshim ne Ligjin NR 8976 date 12.12.2002 “Per akcizat ne Republiken e Shqiperise”
- Per ndryshim ne Ligjin NR 8560 date 22.12.1999 “Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise”
- Per ndryshim ne Ligjin NR 8438 date 28.12.1998 “Per Tatimin mbi te ardhurat”

Mbledhja u drejtua nga Kryetari Z. Genc RULI, Minister i Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes i cili paraqiti rendin e dites si dhe beri nje permbledhje, dhe komentoi ndryshimet perkatese ne paketen fiskale te paraqitur nga Ministria e Financave.

Z. Florjan MIMA, ZV.Minister i Financave, argumentoi nevojën e nderhyrjeve ne keto akte ligjore.

Pas prezantimit te kesaj pakete nga anetaret e KKB rezulton nje verejtje e pergjithshme:

- Diskutimi reth kesaj pakete fiskale, nuk mund te ezaurohet brenda kesaj mbledhje, lind e nevojshme per ta diskutuar me anetaresine e organizatave te biznesit ne nje hark kohor prej 10 dite deri ne dy jave, me qellim per te kontribuar ne permiresimin e ketij kuadri ligjor ne interes te dy paleve, buxhetit dhe biznesit.

Specifike:

1. Per ligjin nr.8438, date 28.12.1998 “ Per tatimin mbi te ardhurat”:

-Verejtja e pergjithshme behet nga te gjithe anetaret, kryesisht nga perfaqesuesit e sektorit te industrive perpunuese, lidhur me shpenzimet per perfaqesim dhe reklama. Sugjerohet qe te rritet niveli i ketyre shpenzimeve deri ne 3% te qarkullimit vjetor. U

theksua nga disa anetare se ky shpenzim mund te diferencohet sipas sektoreve, duke pasur parasysh faktin se ne disa kompani te industrise ushqimore shpenzimet per reklama arrijne deri ne 5 % te qarkullimit vjetor si dhe biznese te tjera te cilat shpenzimet per reklama i kane deri ne 20% apo 30% te qarkullimit vjetor. Gjithashtu u vu ne dukje se ky projekt ligj do tu privoje te drejten bizneseve te reja te cilat e nisin punen nga reklama dhe eshte absurde qe bizneset e reja te kryejne shpenzime per reklama deri ne 1 % te qarkullimit vjetor kur ato mund te kene shume pak qarkullim pasi jane ne fillim te aktivitet te tyre .

U theksua si e rendesishme njohja e nivelit te shpenzimeve per reklama ne kufirin 3-4%, si nje mbeshtetje e fuqishme ne sherbim te marketingut te produkteve dhe sherbimeve per nevojat e biznesit.

- Lidhur me piken “j” te po ketij ligji **“Per sponsorizimet”**:
 - U vu ne dukje se ky ligj do te ule ndjeshem vleren e sponsorizuar nga bizneset dhe si rrjedhoje do te kemi me shume probleme humanitare e sociale, pasi biznesi detyrohet te mbaje rol pasiv ne aspektin social si dhe u propozua qe kufijte e perqindjes per “Per sponsorizimet” qellime tatimore jo vetem te qendroje ne nivelet qe ishte me pare pra 4 % dhe 10 % por te kene tendence rritje ne te ardhmen.
- Ne kete ligj, nje sygjerim tjetër lidhur me germen “n” te nenit **21** njohja e shpenzimeve per paga, vetem kur ato kalojne nepermjet sistemit bankar:
 - Nje nderhyrje e tille konsiderohet pozitive, por ka nevojë qe te lihet nje periudhe testimi apo pergatitore. Pasi ka te beje me pergatitjet dhe infrastrukturen e sistemit bankar qe te perballoje nje sherbim te tille. Gjithashtu theksohet se nuk ka vend per te vendosur penalitete, deri sa te sigurohet regullimi i nje sherbimi te tille nga sistemi bankar dhe u propozua qe ky projekt ligj te hyje ne fuqi me 1 Janar 2008 kur do te hyje ne fuqi edhe tatimi 10% per Sigurimet Shoqerore.
- Germa “o” per shumat e paguara ne Cash:
 - U theksua sidomos nga perfaqesuesit e sektorit te industrise, si shume e veshtire qe te realizohet nga bizneset e vogla, por u theksua se ky detyrim mund te plotesohet menjehere nga bizneset qe bejne pjese ne kategorine VIP apo qe realizojne nje faturim vjetor mbi 150 milion leke. Ne keto kushte lind e nevojshme qe te behet nje klasifikim tjetër i bizneseve nga pikpamja fiskale, duke ndryshuar kufirin e xhiros vjetore per biznesin e vogel nga 8 Milion leke ne vit, te shkoje ne 25 Milion leke ne vit dhe klasa e dyte mbi kete kufi.

Nje sygjerim tjetër lidhur me kete pike eshte qe kufiri prej 10 % te rritet ne 30 % per faturat deri ne 300 000 leke duke detyruar biznesin qe 70 % e ketyre faturave te kryhet nga banka.

- **Germa “p”**:
 - Lidhur me shpenzimet per sherbime te ndertimit dhe montimit, si dhe punime te tjera te faturuara shoqerive te ndertimit, nga biznesi i vogel. Nga perfaqesuesi i sektorit te ndertimit, kete mase te propozuar e konsideron pozitive, por theksoi veshtiresine se te gjithe bizneset e vogla

qe ofrojne keto sherbime per llogari te shoqerive te ndertimit, duhet te aplikojne fature me TVSh, qe do te thote se duhet te kalojne ne biznes te madh. Me qellim garantimin e nje mase te tille, ky ligj per 6 mujorin e dyte te vitit 2007 te konsiderohet periudhe testi, dhe te hyje ne fuqi me 1 janar 2008. Këtu u shpreh edhe shqetesimi i percaktimit me te mire te llojit te biznesit qe ofrojne këto sherbime për shoqerite e ndertimit. Nga perfaqesuesi i shoqates se artizanateve u hodh pyetja: po për artizanet, do te aplikohet ky nen? Ndersa nga Kryetari i Dhomes Tregtise Tirane ky projekt ligj konsiderohet si mohim i se drejtes tregtimit per biznesin e vogel duke e perjashtuar ate nga tregu i sherbimeve ne fushen e ndertimeve, vecanerisht elektrikistet, hidrauliket, mekaniket, montuesit etj. Gjithashtu u cilesua si e padrejte nga Kryetari i Dhomes Tregtise Tirane qe per sa kohe qe nje tatimpagues nuk ploteson volumin e qarkullimit prej mbi 8 milion leke ne vit, te detyrohet per t'u regjistruar si biznes i madh i TVSH-se.

- Ne kete projekt ligj nga te gjithe anetaret e KKB, u sugjerua qe tatimi mbi te ardhurat personale 10% si dhe tatimi mbi fitimin 10% te hyjne ne fuqi bashkerisht ne nje kohe me 1 Janar 2008.

2. Projekt ligji per ndryshimin e ligjit nr.9632, date 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”

- Krahas vleresimit pozitiv qe i behet kesaj mase nga te gjithe anetaret, behet nje sugjerim lidhur me nivelet e taksas mbi ndertesat, lidhur me piken II, ku zeri te tjera te jete i klasifikuar qarte, me qellim qe te mos lere shteg per abuzime.
- Sugjerohet gjithashtu se rritja e kesaj takse per ndertesat ne zonat turistike, nuk duhet pare e njeanshme vetem nga ana fiskale, eshte e rendesishme theksoi perfaqesuesi i Dhomes Britanike, qe te sigurohen te gjitha kushtet e infrastruktures ne zonat turistike, si uji, kanalizimet etj.

3.Projekt ligji per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise:

- Ndryshimet e parashikuara ne kete projekt ligj konsiderohen pozitive qe ndikojne ne luften kunder informalitetit.
- Eshte e nevojshme te saktosohet me mire ndryshimi i statusit te Policise Tatimore, pasi ajo nuk mund te marre attribute si oficeret e policise Gjyqesore, pasi kjo do te coje ne rritjen e presionit ndaj biznesit dhe si rrjedhim do coje ne rritjen e korrupsionit, por gjithashtu u theksua se nuk mund te këtë status te saj, pa marre edhe atributet.
- Nje propozim tjetër ishte qe te hiqet emertimi “polici” dhe te zevendesohet me nje term tjetër.

4. Projekt ligji per Akcizat ne Republiken e Shqiperise:

- Lidhur me ligjin e akcizave u theksuan disa verejtje: Nevoja per te studjuar dhe vleresuar me mire keto masa nderhyrese, pasi mund te ndikojne ne rritjen e cmimve, vecanerisht me e theksuar tek karburantet.

- Gjithashtu nga perfaqesuesit e industrise se prodhimit te birres, u theksua se masa e akcizes se diferencuar eshte pozitive dhe nuk stimulon informalitetin.
- Propozimi per rritjen e akcizes se veres nga 20 ne 50 leke per liter, nuk u duk i drejte, per arsye se nje gje e tille do te dekurajonte prodhuesit vendas, te cilet dy tre vitet e fundit kane filluar te rrisin investimet e tyre dhe do te favorizonte e bente konkurrues prodhuesit e rrushit ne vendet fqinj ne kurriz te prodhuesve vendas.
- Sipas perfaqesuesit te shoqates se Agrobiznesit, do te kete reagime nga biznesi per kete ligj, pasi do te sillte veshtiresi nga konkurenca e pandershme qe do ti behet nga biznesi i vogel informal. Akciza per pijet e vendit duhet te jete me e vogel se per ato te importit.
- Akciza per benzinen duhet te jete me e vogel, ose te konsiderohet mosrritja e saj per benzinen 98 oktan e lart, ne krahasim me gazoilin me qellim per te stimuluar futjen ne treg te makinave me benzine, ne kendveshtrimin e ruajtjes se mjedisit.

5. Lidhur me pagesen e sigurimeve shoqerore, nje ceshtje e ngritur nga perfaqesuesit e biznesit, jashte kesaj pakete fiskale:

- Ngrihet shqetesimi per pagesen e sigurimeve shoqerore, duke ju referuar pages minimale, e cila eshte e diferencuar sipas rretheve aq me shume krahasuar me Tiranen. Rezulton dhe ka nje tendence se vetem per hire te kesaj takse, bizneset tentojne te levizin nga Tirana dhe te spostohen ne rethe te tjera, pasi paguhet me pak.
- Nje veprim i tille krijon kushtet e zhvillimit te nje konkurrence te padrejte.

Ne perfundim te ketij diskutimi te kesaj pakete fiskale, hidhet idea:

Nga qeveria te shikohet mundesia e futjes se skemes se TVSH-s, ne tere kategorite e biznesit, si nje mase teper e rendesishme ne uljen e informalitetit. Kjo e ben me shume shqetesuese, vecanerisht per sektorin e bujqesise te cilet jane totalisht jashte kesaj skeme, duke vene ne veshtiresi edhe sektorin e industrise i cili ka nevojte te siguroje lendet e para nga bujqesia. Te shikohet mundesia e studimit te kesaj skeme ne prodhimin bujqesor , duke futur hallken e grumbullimit.

Ne perfundim, nga Kryetari i Keshillit Konsultativ te Biznesit u theksua se keto sugjerime te bera nga biznesi, jane te vlefshme te cilat do te gjejne permiresime dhe reflektime edhe ne fazen e diskutimit ne komisionet parlamentare. U theksua gjithashtu nga ana e tij se pas miratimit te kesaj pakete, periudha e 6 mujorit te dyte 2007, te konsiderohet si nje periudhe prove lidhur me ecurine e zbatimit te ketyre masave te propozuara ne kete pakete.